

VENDIM
Nr.4 date 2.12.1992

**PËR FUQIZIMIN E KONTROLLIT PËR PRODHIMIN, RUAJTJEN, TRANSPORTIMIN
DHE TREGTIMIN E PRODUKTEVE USHQIMORE**

Me qellim që të garantohet cilësia e produkteve ushqimore dhe të mbrohet shëndeti i konsumatorëve, në zbatim të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavaruara dhe privatizimit", të ligjit nr.7630, datë 28.10.1991 "Për standartizimin dhe cilësinë", të ligjit nr.7443, datë 31.1.1991 "Për policinë fuqimanciare" dhe të ligjit nr.7463, datë 2.12.1992 "Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror", Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Regjistrimi në gjykatë për personat fizikë dhe juridikë vendas e të huaj, që merren me prodhimin produkteve ushqimore, të bëhet pasi të paraqiten lejet nga organet kompetente:

a) Lejen e aftësisë profesionale për prodhimin e produkteve ushqimore e gëzojnë gjithë shtetasit që kanë arsimin e lartë e të mesëm profesional, ose që kanë dëshmi profesionale, në përputhje, me ligjin e prodhimit. Kur personi juridik që ushtron veprimtari prodhuese nuk gëzon të drejtën e ushtrimit të profesionit, merr në punë specialistë që plotësojnë kushtet profesionale dhe e kanë lejen përkatëse të ushtrimit të profesionit.

b) Leja që garanton plotësimin e kërkesave teknologjike.

c) Leja që garanton plotësimin e kërkesave higjieniko-shëndetësore.

ç) Çdo asortiment të shoqërohet me kampionin, përbërësit, parastandartin, standartin e marketimin, duke ruajtur autorësinë e prodhimit.

2. Lejet sipas shkronjave "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij vendimi jepen nga drejtorja e bujqësisë dhe e ushqimit në rreth, sipas shkronjës "c" nga inspektorati sanitar shtetëror në rreth, kurse sipas shkronjës "ç" nga organet e standartizimit dhe të cilësisë në rreth.

Kërkesat teknologjike dhe higjieniko-shëndetësore përcaktohen me rregullore të veçanta nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit.

3. Regjistrimi në gjykatë për personat fizikë e juridikë, vendas e të huaj, që merren me ruajtjen, transportimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore, të bëhet pasi të paraqitet leja që garanton plotësimin e kërkesave higjieniko-shëndetësore, e cila jepet nga inspektorati sanitar shtetëror në rreth.

4. Lejet jepen nga organet përkatëse në bazë të kontrollit të objektit ose të mjeteve ku do të ushtrohet veprimtaria ose, në mungesë të tyre, në bazë të garancive që jep subjekti kërkuar.

5. Vendimi për ushtrimin e veprimtarisë jepet nga gjykata në rreth, kur janë plotësuar kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi.

6. Moszbatimi i procedurave të përcaktuara në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi quhet ushtrim veprimtarie pa leje dhe ndëshkohet sipas ligjeve në fuqi të organeve të specializuara.

7. Produktet ushqimore të prodhuara në vend, lëndët e para dhe ndihmëse ushqimore të vendit e të importit, si dhe prodhimet e papaketuara të konsumit, para se t'i nënshtrohen përpunimeve të mëtejshme, kontrollohen nga organet në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, të cilat lëshojnë certifikatën e cilësisë sipas kërkesave të standartit dhe parastandartit, kundrejt pagesës së pronarit të mallit.

8. Produktet ushqimore të gatshme të importit të paketuara që kalojnë drejtpërdrejt te konsumatori, para se të çohen në treg, kontrollohen nga organet në vartësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit dhe të Drejtorisë së Standartizimit e të Cilësisë, kundrejt pagesës së pronarit, dhe pajisen me dokumentet përkatëse që vërtetojnë respektimin e normave higjienike dhe të treguesve cilësorë të standartit ose parastandartit.

9. Zotëruesi i produktit ushqimor të importuar detyrohet që para zhdoganimit, sipas natyrës së produkteve ushqimore të importuara, të njoftojë organet përkatëse të kontrollit në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit dhe të Drejtorisë së Standartizimit e të Cilësisë.

10. Të gjitha produktet ushqimore, pavarësisht se janë të shoqëruara me dokumentacionin përkatës për sasinë, certifikatën e origjinës dhe cilësinë ose fletanalizën, zhdoganohen, vetëm pasi të jenë marrë mostrat për analiza laboratorike nga organet përkatëse të përcaktuara në pikat 7 dhe 8 të këtij vendimi. Një kopje e dokumentacionit të marrjes së mostrës u lihet organeve doganore.

11. Certifikata e cilësisë e hartuar nga organet në vartësi të Drejtorisë së Standartizimit dhe të Cilësisë, i dërgohet organeve në vartësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, të cilat, duke u mbështetur edhe në ekspertizën higjienike, ekzaminimet laboratorike të kryera nga ana e tyre dhe, në rastet e nevojshme, edhe për praninë e lëndëve radioaktive, lëshojnë një raport-analizë që lejon kalimin për konsum drejtpërdrejt në treg të produkteve ushqimore të importuara, të përcaktuara në pikën 8 të këtij vendimi. Zotëruesi i produktit ushqimor të importuar e hedh atë për konsum në treg dhe prodhim, vetëm pasi ka siguruar raport-analizën përkatëse nga organet në vartësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit dhe të Ministrisë së Bujqësisë e të Ushqimit.

12. Ndihmat ushqimore humanitare nuk shpërndahen te konsumatori, pa iu nënshtruar procedurës së kontrollit higjieniko-shëndetësor.

13. Për rastet e veçanta Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit të përcaktojë kriteret për praninë e lëndëve radioaktive në produktet ushqimore të importuara.

14. Nëse laboratorët e rretheve nuk janë në gjendje të kryejnë analiza të plota, këto të kryhen përkatësisht në Institutin e Higjienës dhe Epidemiologjisë dhe në Institutin e Industrisë Ushqimore.

15. Çdo lëvizje e mallit në prodhim e tregtim të shoqërohet me dokument të rregullt origjinal e jo të fotokopjuar. Dokumenti të ketë serinë e tij dhe në të të shënohet personi fizik, juridik dhe adresa e shitësit. Përveç shënimeve që bëhen për emërtimin e mallit, sasinë, vleftën, datën etj., të shënohet dhe numri, data e fletanalizës dhe organi që e ka lëshuar këtë të fundit për lejimin e përdorimit të produktit ushqimor. Shitësi i mallrave duhet të shënojë në dokument emrin dhe adresën e plotë të blerësit.

Ndalohet rreptësisht lëvizja e produkteve ushqimore pa këtë dokumentacion. Produktet ushqimore pa dokumente të rregullta sekuestrohen menjëherë nga organet përkatëse.

16. Për vlerësimimin e produkteve ushqimore të importuara që nuk ka kampione, përbërës, parastandarte, standarte e marketime shqiptare, të merren si rekomandime normat e Kodeksit Ushqimor të FAO/OMS-it.

17. Aparati gazkromatograf në administrim të Albkontrollit t'i jepet në kalim kapital Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit.

18. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, sipas kërkesave të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, dhe drejtoria e Standartizimit dhe e cilësisë të parashikojë në projektbuxhetin e vitit 1993 fonde për fuqizimin e kontrollit të produkteve ushqimore me automjete, specialistë, bazë laboratorike, si dhe për kualifikimin e specializimin e kuadrit.

19. Për çdo shkelje procedurale e profesionale prej specialistëve të ngarkuar me kontrollin dhe vlerësimin e produkteve ushqimore, kur shkelja nuk përbën vepër penale, të merret masë disiplinore deri në largimin nga puna.

20. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe Drejtoria e Standartizimit dhe e Cilësisë.

21. Dispozitat dhe aktet e tjera nënligjore që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi